

**MBI  
AUDITIMIN E USHTRUAR NË  
BASHKINË LUSHNJE**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Lushnje**, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 165, datë 15.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 771/7, datë 13.12.2014, i ka rekomanduar z. Fatos Tushe, Kryetar i Bashkisë Lushnje, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Lushnje nuk ka hartuar një plan për lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjike në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve.

**1.1 Rekomandim:** Të hartohet plani për përcaktimin e prioriteteve strategjike në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nuk u gjet regjistri i raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive. Ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e tyre sipas nenit 21, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Gjithashtu nuk është miratuar dhe vënë në funksionim sistemi informacioni dhe komunikimi.

**2.1 Rekomandim:**

**a.** Nga ana e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, të merren masa për hapjen dhe mbajtjen e regjistrit të raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

**b.** Për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues të regjistrohen dhe raportohen masat e marra për parandalimin e tyre, gjithashtu të miratohet dhe vihet në funksionim sistemi informacionit dhe komunikimit

**Brenda datës 31.3.2015 dhe vijim**

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Lushnje është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës në kundërshtim me nenet 153 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit në vlerën 5,213,684 lekë, pavarësisht ndjekjes në rrugë ligjore dhe konstatimeve nga ana e NJQV të Vendimeve të Gjykatës për dëm shpërblimet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përgjegjësia është tërësisht e institucionit, i cili nuk ka analizuar të gjitha vendimet, që kanë sjellë dëm efektiv për buxhetin e shtetit dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e përgjegjësive administrative për shkaktarët.

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Lushnje të nxjerrë përgjegjësit për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, për shkaqe të pa argumentuara dhe të pa

mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore duke paguar shumën **5,213,684 lekë**.

**Brenda datës 31.3.2015**

**4. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar 2012, 2013 dhe 2014, nuk janë programuar, regjistruar në kontabilitet dhe pa arkëtuar taksat vendore në vlerë **27,293,186 lekë** e cila përbën mungesë të ardhurash të munguara në Buxhetin e Bashkisë Lushnje, respektivisht: Taksa mbi token bujqësore në vlerë **20,205,586 lekë** dhe tarifa e pastrimit në vlerë **7,087,600 lekë**. Në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për Taksat dhe Tarifat Vendore dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak*”.

**4.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave në Bashkinë Lushnjë, në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, të bëjë llogaritjet dhe të nxjerrë njoftim vlerësimet, të regjistrohen në kontabilitet dhe të kërkohet arkëtimi i taksave vendore për popullatën në vlerën **27,293,186 lekë**, sipas regjistrimit për fondin e tokës bujqësore për 3407.68 ha, dhe mbi numrin e familjeve të regjistruara në gjendjen civile, duke zbatuar procedurat tatimore dhe administrative.

**Brenda datës 31.3.2015**

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Lushnjë nuk e ka përfunduar procesin e regjistrimit në ZVRPP Lushnje, për pronat e transferuara me V.K.M. nr. 175 datë 6.3.2012, “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnje*”, veprim ky në kundërshtim me kreun IV, nenet 13 e 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”.

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Lushnjë të marrë masat e nevojshme, për regjistrimin e aseteve në ZVRPP Lushnje, të cilat i kanë kaluar kësaj Bashkie me VKM nr. 175 dt 6.3.2012 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnjë*”.

**Brenda datës 31.3.2015**

**6. Gjetje nga auditimi:** Mungon inventarizimi fizik dhe përfshirja e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël në zërin “*Toka, troje, terrene etj*” pasi në asnjë bilanc të periudhës objekt auditimi, kjo vlerë jo vetëm që nuk pasqyrohet në rreshtin 10, llogaria 210, por gjithashtu nuk pasqyrohet as bilanci i fondit të tokës me strukturën ligjore përkatëse në mënyrë ekstra kontabël, në kundërshtim me: Kreun II Neni 7 pikat 1,2 Kreu III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar.

**6.1 Rekomandim:** Të merren masa për kryerjen e inventarizimit fizik dhe përfshirja e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël i zërit: “*Toka, troje, terrene, objekte etj*”, në rreshtat dhe llogaritë përkatës, si dhe në bilancin e fondit të tokës.

**Brenda datës 31.3.2015**

**7. Gjetje nga auditimi:** Dhënia e 4 (katër) objekteve me qera, për vitin 2012, vitin 2013 dhe 2014, me kontrata 1 vjeçare, pasuri të cilat nuk janë të regjistruar më parë në ZVRPP. Në këto kushte dhënia e objekteve me qera, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk është i përcaktuar në nenin 678 të **Kodit Civil**, “*Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet*”, pronat objekt i këtyre kontratave edhe pse janë në listën e pronave të transferuara me VKM, nuk janë në pronësi të Bashkisë Lushnjë dhe nuk posedohen dokumente pronësie.

**7.1 Rekomandim:** Bashkia Lushnjë, të marrë masa dhe të kryejë procedurat administrative, bazuar në nenin 116, pika “c” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Për Kodin e Procedurës Administrative*”, për deklarimin të pavlefshëm të 4 kontratave për dhënie e objekteve me qera personave për aktivitet biznesi dhe shfrytëzimi për periudhën nga viti 2012, vitin 2013 dhe 2014, trajtuar në tabelën më sipër.

### **Brenda datës 31.3.2015**

**8. Gjetje nga auditimi:** Janë nënshkruar kontratat për dhënien e 4 (katër) objekteve me qera, të cilat nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkiak, veprim ky në kundërshtim me shkronjën “e” të nenit 32, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, ku parashikohet se: *Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.*

#### **8.1 Rekomandim:**

**a.** Bashkia Lushnjë, të rishikojë kontratat e më sipërme dhe ti paraqes për miratim në këshillin Bashkiak.

**b-** Të gjitha kontratat që do të nënshkruhen për tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve, të miratohen në Këshillin Bashkiak.

### **Brenda datës 31.1.2015 e në vijim**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor nuk:

- Janë vendosur sanksionet ligjore me gjobë për shkeljet e konstatuara në 13 raste në vlerë **3,900,000 lekë.**

- Janë dërguar Drejtorisë së Financës gjobat e vendosura dhe të pa arkëtuara në 18 raste në vlerë **2,633,012 lekë**, për të kryer regjistrimin e tyre në kontabilitet, si dhe në bashkëpunim me Degën e Financës.

- Janë vendosur penaltete për gjobat e pa arkëtuara në 18 raste brenda afatit ligjor në vlerën **1,587,000 leke**, në kundërshtim me nenet 22, 30, 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”.

**9.1 Rekomandim:** Bashkia Lushnje të marrë masa dhe të vendosë sanksione ligjore me gjobë për shkeljet e konstatuara në 13 raste në vlerë 3,900,000 lekë, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative. Ti dërgohen Drejtorisë së Financës, gjobat e vendosura të pa arkëtuara, në 18 raste në vlerë 2,633,012 lekë, për të kryer regjistrimin e tyre në kontabilitet. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të vendosin penaltete për gjobat e pa arkëtuara në vlerë 1,587,000 leke. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **8,120,012 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit

### **Brenda datës 30.4.2015**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 8.5.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative*”, pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **11.477.860 lekë**, si më poshtë.

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa shtesë për kualifikim, gradë apo titull shkencor, z. *Sh.T.* në vlerë 270,000 lekë, znj. *M.Ç.* në vlerë 63,000 lekë, dhe znj. *M.C.* paguar më tepër shtesë për diferencë page në vlerë 40,950 lekë, pra **gjithsej në vlerë 373.950 lekë.** Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “*Për Klasifikimin e Funksioneve, Grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për Efekt Page dhe Caktimin e Kufijve të Pagave të Punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore*”, lidhja nr. 2 i ndryshuar, me VKM nr. 598, datë 27.4.2009, nr. 693, datë 18.8.2010, nr. 553, datë 11.8.2011, nr. 518, datë 16.8.2012 dhe nr. 586, datë 17.7.2013.

**1.1. Rekomandim** Bashkia Lushnje të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit dhe ato përmbartimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **373.950 lekë**, për personat e sipërcituar.

#### **Brenda datës 31.3.2015**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nuk është mbajtur tatimi në burim për z. V.S. me detyrë ish supervizor për shërbimet në zbatim të vendimit të gjykatës të rrethit gjyqësor Lushnje nr. regjistrat 238 (844) datë 21.7.2011, detyrime nga marrëdhëniet e punës, në vlerë **57,240 lekë**. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për Tatimin mbi të Ardhurat*”, i ndryshuar.

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Lushnjë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbaremore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **57,240 lekë**.

#### **Brenda datës 31.3.2015**

**3. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, nuk është programuar, regjistruar në kontabilitet dhe pa arkëtuar tarifa e pastrimit, për çdo kantier ndërtimi, nga subjektet ndërtuese për periudhën nga marrja e lejes së ndërtimit deri në marrjen e lejes së përdorimit nga 8 subjekte në shumën **1,630,000 lekë**

**3.1. Rekomandim** Zyra e Taksave të Bashkisë Lushnje të nxjerrë njoftim vlerësimet të regjistrohen në kontabilitet dhe të arkëtohen taksat vendore për popullatën në vlerën **1,630,000 lekë**, referuar tabelës më sipër.

#### **Brenda datës 31.6.2015**

**4. Gjetje nga auditimi:** Zyra e Tatim Taksave për periudhën 2012, 2013 dhe 2014, për subjektet e biznesit të vogël, dhe 2011- 2014 për subjektet e biznesit të madh, për detyrimet tatimore të pa paguara në afatin e caktuar ligjor, nuk ka vendosur sanksionet ligjore me gjobë deri në masën 25 % të shumës së detyrimit të pa likuiduar, (sa trajtuar në aneksin nr. 3 bashkëlidhur raportit të auditimit) në vlerë **7,143,000 lekë**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar, neni 114, “*Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit*”, pika 1.

**4.1. Rekomandim:** Zyra e Taksave të Bashkisë Lushnje të nxjerrë njoftim vlerësimet të regjistrohen në kontabilitet dhe të arkëtohen detyrimet tatimore në shumën **7,143,000 lekë**

#### **Brenda datës 31.3.2015**

**5. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nuk janë vendosur sanksionet ligjore, në masën 4/1000 penalitet për çdo ditë vonese, për përfundimin e punimeve jashtë afatit të parashikuar në kontratë për:

- Subjekti “A.. & B” Shpk me Nipt K83927403E Lushnjë, në vlerë **775,360 lekë**.

- Subjekti “B...U” Shpk me Nipt K72627402H Fier, në vlerë **582,915 lekë**.

Në kundërshtim me VKM. Nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, dhe neni 27 të kontratës.

**5.1. Rekomandim:** Bashkia Lushnje të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbaremore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **1.448.275 lekë**.

#### **Brenda datës 31.3.2015**

**6. Gjetje nga auditimi:** Sekretaria Teknike në një rast, për leje zhvillimore ndërtimi për “Ngritje kati 1 kat mbi objekt 4 kat” për zhvillues, shoqëria “Ll..O” shpk dhe pronar Y.M. nuk është bërë kontrolli i projektit të miratuar dhe përllogaritja e saktë e sipërfaqes totale të ndërtimit nga ku rezulton një diferencë e pa paguar nga subjektet në vlerën 36.324 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik, veprimet vijnë në kundërshtim me VKM nr. 502, datë 13.7.2011 “*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*”, ndryshuar me VKM nr. 314 date 13.3.2013 Pika 8, neni 14.

**6.1. Rekomandim:** Për vlerën **36.324 lekë**, sa paguar më pak taksën e lejes së ndërtimit në një rast, nga mos kontrolli i projektit të miratuar dhe përllogaritjes saktë të sipërfaqes totale të ndërtimit.

#### **Brenda datës 31.3.2015**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e Sekretarisë teknike dhe Drejtorisë së Financës në 5 raste, pagesa për lejet e ndërtimit nuk është kryer brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, duke mos kryer përlllogaritjen e gjobës në vlerën 0.2 % në ditë për çdo ditë vonesë në vlerën **736.471 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik, në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 10 078, datë 16.2.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8405”, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

**7.1. Rekomandim:** Për vlerën **736.471 lekë**, sa nuk është llogaritur dhe paguar kamat vonesa e gjobës në vlerën 0.2 % në ditë, për ditë vonesë për 5 subjekte, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 19.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

**Brenda datës 31.3.2015**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në pagesën e vlerës së kontratës për periudhën (pesë mujore) nga data 31.7.2010 deri në datën 31.12.2010 në vlerën 5.454.470 lekë me tvsh, ndërkohë që kontrata është nënshkruar më datë 4.8.2010, pra 4 ditë vonesë dhe për rrjedhojë Operatori Ekonomik “S..A-AL” sh.p.k Lushnjë, ka përfituar padrejtësisht shumën **142.600 lekë me tvsh**.

**8.1. Rekomandim:** Bashkia Lushnje të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbareme për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **142,600 lekë**, nga Operatori Ekonomik “S..A-AL” sh.p.k Lushnje.

**Brenda datës 31.3.2015**

### **C. MASA DISIPLINORE**

**C.I-**Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, miratuar më datën 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, rekomandojmë që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**vërejtje me shkrim**” punonjësve të më poshtëm:

**1. M.H. me detyrë Drejtore e Zyrës së Kontroll Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.**

- Nga sekretaria teknike në një rast, për leje zhvillimore ndërtimi për zhvillues, shoqëria “L.L.O” shpk, nuk është bërë kontrolli i projektit të miratuar dhe përlllogaritja e saktë e sipërfaqes totale të ndërtimit nga ku rezulton një diferencë e pa paguar nga subjekti në vlerën 36.324 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, ndryshuar me VKM nr. 314 date 13.3.2013 Pika 8, neni 14.

- Nga ana e sekretarisë teknike dhe drejtorisë së financës, në 5 raste pagesa nuk është kryer brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, duke mos kryer përlllogaritjen e gjobës në vlerën 0.2 % në ditë, për ditë vonesë në vlerën 736.471 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 10 078, datë 16.2.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar

**2. M.Ç. me detyrë specialist për infrastrukturën në Drejtorinë e Shërbimeve,**

**3. M.M. me detyrë specialiste për ligjshmërinë në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit,**

**4. B.B. me detyrë specialiste ne drejtorinë e planifikimit të territorit,** për të meta dhe mangësi, pasi nuk është përfunduar procesi i regjistrimit në ZVRPP Lushnjë të pronave të transferuara me VKM nr. 175 dt 6.3.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnje”, duke vepruar në kundërshtim me kreun IV nenin 13, neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

**5. F.P. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë** për të meta dhe mangësi, në mos marrjen e masave për vjeljen e detyrimeve nga gjobat, kamat vonesat dhe debitorë të tjerë, duke i shkaktuar Bashkisë Lushnje të ardhura të munguara në

shumën 8.120.012 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" neni 22, 30, 44.

**C.II.** Në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ligjin nr. 152/2013, miratuar më datën 30.5.2013 "Për Nëpunësin Civil" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, që për shkeljet e konstatuara, të fillojë procedura për marrjen e masave disiplinore:

**"Vërejtje"** deri në **"zgjidhjen e kontratës së punës"**, duke gjykuar në bazë të përgjegjësisë rast mbas rasti, për punonjësit si më poshtë:

**1. M.Ç. me detyrë ish- drejtore e financës**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe kryetarit të komisionit për blerjet e vogla për periudhën korrik 2011 deri me 1.8.2012, dhe aktualisht specialiste në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike, për të metat dhe mangësitë si më poshtë:

- Nuk ka dokumentuar procedurën e prokurimit, për objektin: *Sistemim, asfaltim i bllokut të banimit në lagjen: "Skënder Libohova" Zona 1.* në kundërshtim me pikën 3/1 të nenit 12, pikën 4, neni 22 dhe neni 34 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, piken 4 shkronja "i" të kreut V të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, kreu VI pika 1 shkronja "d",

- Për të meta dhe mangësi për dy subjekte, për përfundimin e punimeve jashtë afatit kohor të parashikuar në kontratë dhe pa vendosur penalitet, në kundërshtim me nenin 27 të kontratës.

- Për të meta dhe mangësi në "Prokurimin Publik" Blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I, pika 1 germa b, pika 3 germa a dhe d, II pika 1 dhe i III- të pika 3 germa b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

- Nuk është mbajtur tatimi mbi të ardhurat personale në një rast, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi, për pagesa të kryera për vendime gjyqate, nga marrëdhëniet e punës, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, date 11.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 153 dhe 154, nuk janë analizuar vendimet për dëmin ekonomik të krijuar, nuk është kërkuar nxjerrja e përgjegjësisë ndaj shkaktarëve.

-Për mos zbatimin e planit të buxhetit sipas strukturës buxhetore, për shpenzimet faktike të kryera, kaluar në Gr. 0 kap. 5 prog. 1110 llogaria 602, në vlerë **2,472,000 lekë**, shërbimi i gjelbërimit të qytetit tetor - nëntor 2011, duhet të ishte kaluar në Gr. 0 kap. 5 prog. 6260, llogaria 602 shpenzime për pastrimin e qytetit.

-Për të meta dhe mangësi, në hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, nuk ka projekte për ndryshimin e buxhetit gjatë zbatimit, mos parashikimin e detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm në masën prej 50% për vitin ushtrimor dhe mbulimin e tyre me fonde, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8652, date 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dalë në zbatim të ligjit "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", me udhëzimin nr. 2, date 2.6.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit ", i ndryshuar, paragrafi 101.

- Për të meta dhe mangësi për "Prokurimin Publik", blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I, pika 1 germa b, pika 3 germa a dhe d, II pika 1 dhe i III- të pika 3 germa b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

**2. J.B. me detyrë ish-drejtores e drejtorisë së financës,** për periudhën 01.8.2012 deri me 11.10.2012, dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

- Për të meta dhe mangësi në “Prokurimin Publik”, blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I, pika 1 gërma b, pika 3 gërma a dhe d, II pika 1 dhe i III- të pika 3 gërma b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Për të meta dhe mangësi, në zbatimin e planit të buxhetit, për shpenzime të programuara dhe të pa realizuara, ose të kryera në fakt dhe të pa financuara për mungesë fondesh, për shpenzime operative dhe investime, nuk ka projekte për ndryshimin e buxhetit gjatë zbatimit, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8652, date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

**3. T.K. me detyrë nën kryetare Bashkia,** në cilësinë e kryetares së komisionit të vlerësimit të ofertave, në cilësinë e kryetarit të komisionit, për blerjet me vlera të vogla.

**4. K.H. me detyrë juriste e prokurimeve,** në cilësinë e jurist në njësinë e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit.

**5. L.H. me detyrë specialiste e ndihmës ekonomike,** në cilësinë e specialistëve në njësinë e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit.

**6. M.L. me detyrë inxhinierë në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit,** në cilësinë e specialistes në njësinë e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit, Për të metat dhe mangësitë si më poshtë:

- Nuk kanë dokumentuar procedurën e prokurimit, me objekt: *Sistemin, asfaltim i bllokut të banimit në lagjen: “Skënder Libohova” Zona 1,* në kundërshtim me pikën 3/1 të nenit 12, pikën 4, neni 22 dhe neni 34 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, pikën 4 shkronja “i” të kreut V të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI pika 1 shkronja “d”,

- Për të meta dhe mangësi për dy subjekte, për përfundimin e punimeve jashtë afatit kohor të parashikuar në kontratë dhe pa vendosur penalitet, në kundërshtim me nenin 27 të kontratës.

**7. L.B. me detyrë Drejtores e Drejtorisë së Financës.**

- Për të meta dhe mangësi për një subjekte, për përfundimin e punimeve jashtë afatit kohor të parashikuar në kontratë dhe pa vendosur penalitet, në kundërshtim me nenin 27 të kontratës.

- Për të meta dhe mangësi, për pagesa të kryera për vendime gjyqate me urdhër nga Përmbartuesi Gjyqësor, për ekzekutim të detyrimeve nga marrëdhëniet e punës, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, date 11.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar nenin 153 dhe 154, nuk janë analizuar vendimet për dëmin ekonomik të krijuar, nuk është kërkuar nxjerrja e përgjegjësisë ndaj shkaktarëve.

- Për të meta dhe mangësi, në hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, për shpenzime të programuara dhe të pa realizuara, ose të kryera në fakt dhe të pa financuara për mungesë fondesh, për shpenzime operative dhe investime, nuk ka projekte për ndryshimin e buxhetit gjatë zbatimit, mos parashikimin e detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm në masën prej 50 %, për vitin ushtrimor dhe mbulimin e tyre me fonde, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8652, date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dalë në zbatim të ligjit “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, me udhëzimin nr. 2, date 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, paragrafi 101.

- Pasi mungon inventarizimi fizik dhe regjistrimi në pasqyrën e bilancit kontabël në zërin “toka, troje, terrene etj”, gjithashtu nuk është pasqyruar në regjistrin për fondin e tokës, mosveprim ky në kundërshtim me ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për kryerjen dhe

*funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar, me VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Bashki”, si dhe me: Kreun II Neni 7 pikat 1,2 Kreu III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.*

**8. A.H.** *me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, dhe në cilësinë e kryetarit dhe anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.*

- Për të meta e mangësi për pagesat e kryera për dy punonjës, shtesa për kualifikim gradën apo titullin shkencor dhe një punonjës për shtesa të tjera, diferencë page, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të qeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 553 datë 11.8.2011 i ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi në “Prokurimin Publik” Blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I, pika 1 germa b, pika 3 germa a dhe d, II pika 1 dhe i III- të pika 3 germa b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

**9. F.A.** *me detyrë specialiste e nivelit të lartë për pagat,*

-për të meta e mangësi për pagesat e kryera, shtesa për kualifikim gradën apo titullin shkencor dhe shtesa të tjera, diferencë page, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të qeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 553 datë 11.8.2011 i ndryshuar.

**10. V.K.** *me detyrë juriste në cilësinë e anëtarit të komisionit,*

**11. M.K.** *me detyrë specialist i mjedisit në cilësinë e anëtarit të komisionit,*

**12. S.G.** *me detyrë ish- drejtore e Drejtorisë së Financës, aktualisht përgjegjëse e zyrës së auditit në cilësinë e kryetarit të komisionit,*

**13. L.S.** *me detyrë ish- Drejtor i Drejtorisë Juridike, aktualisht juriste në ndërmarrjen e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, në cilësinë e kryetarit të komisionit.*

Për të meta dhe mangësi për “Prokurimin Publik” Blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I, pika 1 germa b, pika 3 germa a dhe d, II pika 1 dhe i III- të pika 3 germa b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**14. M.A.** *me detyrë specialiste e nivelit të lartë për taksën e biznesit të vogël,*

**15. E.K.** *me detyrë ish specialist i nivelit të lartë dhe Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën 10.4.2014 e në vazhdim,*

**16. V.Ç.** *me detyrë specialist i nivelit të lartë për periudhën 12 shkurt 2012 e në vazhdim,*

**17. E.R.** *me detyrë specialist i nivelit të lartë për periudhën 10 prill 2014 e në vazhdim,*

**18. D.K.** *me detyrë specialist i nivelit të lartë për periudhën 10 prill 2014 e në vazhdim,*

**19. N.D.** *me detyrë ish Kontabilist deri në janar 2014 dhe në vazhdim inspektor i biznesit të vogël,*

**20. L.Z.** *me detyrë ish inspektore e nivelit të lartë, për borxhin dhe masat shtrënguese deri në janar 2014 dhe në periudhën në vazhdim specialist i nivelit të lartë për taksën e tokës bujqësore dhe familjare,*

**21. Th.Gj.** *me detyrë specialist i nivelit të lartë, për taksën e biznesit të vogël,*

**22. E.Sh.** *me detyrë Specialiste e nivelit të lartë, për borxhin dhe masat shtrënguese për periudhën 17.8.2011 e në vazhdim (Me kontratë).*

**23. L.T.** *me detyrë operatore.*

Për të meta dhe mangësi në programimin, realizimin e të ardhurave dhe vendosjen e sanksioneve ligjore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 ndryshuar, me ligjin nr. 9745, datë 28.5.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimi i MF dhe MB nr. 655/1, datë 6.2.2007, si dhe ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” me ndryshime.



**Shënim:**

Për punonjësit që nuk janë më në marrëdhënie pune, nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “**Vërejtje me shkrim**” përkatësisht:

1. **A.H.** ish- kryeinspektorë të INUV.
2. **B.D.** ish- kryeinspektorë të INUV.
3. **E.P.** ish- kryeinspektorë të INUV.
4. **Z.Rr.** ish- kryeinspektorë të INUV.
5. **L.D.** ish- kryeinspektorë të INUV.
2. **E.D.** me detyrë ish- jurist në Drejtorinë Juridike.
6. **K.P.** me detyrë ish- specialist në Drejtorinë e Projekteve
7. **H.H.** me detyrë ish- specialist në zyrën e ZAMT.
8. **E.Q.** me detyrë ish- juriste.
9. **G.H.** me detyrë ish- juriste,
10. **A.Ç.** me detyrë ish- juriste,
11. **R.M.** me detyrë ish inspektore e nivelit të lartë për biznesin e vogël.
12. **L.Sh.** me detyrë ish- specialiste e nivelit të lartë për biznesin.
13. **N.Z.** me detyrë ish inspektore e nivelit të lartë, për taksën e tokës bujqësore dhe familjare.
14. **P.S.** me detyrë ish Inspektor i nivelit të lartë për biznesin e madh.

Për drejtuesit e mësipërm të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Genc Koka, Dorino Mece dhe Din Zeneli më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**